2021

GRATË DHE BURRAT NË SHQIPËRI

WOMEN AND MEN IN ALBANIA

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

UN WOMEN | WOMEN COUNT
MAKING EVERY WOMAN AND GIRL COUNT

Gratë dhe Burrat në Shqipëri
Women and Men in Albania
2021

Drejtor Botimi / Director of Publication:
Elsa Dhuli / PhD

© Copyright INSTAT 2021

Botimi:
"Gratë dhe Burrat në Shqipëri, 2021"
"Women and Men in Albania, 2021"
Gjuha e librit: Shqip – Anglisht
Autori: INSTAT

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë,
pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

No part of this publication can be reproduced or transmitted in any form or by
any means without the prior written permission of the copyright holder.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Blv. "Zhan d'Ark", Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 228300
E-mail: info@instat.gov.al
Web: www.instat.gov.al

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

GRATË DHE BURRAT NË SHQIPËRI

WOMEN AND MEN IN ALBANIA

2021

UN WOMEN | WOMEN COUNT

MAKING EVERY WOMAN AND GIRL COUNT

Parathënie dhe falënderime "Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2021"

"Burrat dhe Gratë në Shqipëri" është një publikim me periodicitet vjetor, i cili paraqet të dhëna në fusha të ndryshme të jetës të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë në kuadër të arritjes së barazisë gjinore.

Kapitujt e përfshirë në këtë botim, pasqyrojnë fusha të ndryshme të të dhënave me bazë gjinore të cilat janë përpunuar dhe vendosur në kontekst nga stafi i INSTAT duke i bërë ato më të lehta dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

Statistikat dhe treguesit e prezantuar në këtë publikim do t'u shërbejnë politikëbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve të ndryshëm për të analizuar në një kontekst të gjerë zhvillimet gjinore në Shqipëri.

Qëllimi kryesor i publikimit është të paraqesë të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke synuar që statistikat jo vetëm të mblidhen, analizohen dhe prezantohen sipas gjinisë, por dhe të reflektojnë problematikat e shoqërisë për monitorimin e politikave ndër-sektoriale mbi arritjen e barazisë gjinore dhe arritja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Risi në publikimin e këtij viti janë treguesit nga mbojtja sociale ku përfshihen të dhëna për punëkërkues të papunë të regjistruar që përfitojnë pagesë papunësi, ndihmë ekonomike si dhe qendrat sociale për të moshuarit, si dhe disa tabela të reja nga Anketa e të Ardhurave. Publikimi gjithashtu përmban Indeksin e Pabarazisë Gjinore dhe Setin Minimal të Treguesve Gjinorë, i cili përfshin 52 tregues të përcaktuar nga Komisioni Statistikor në bashkëpunim me UN Women për matjen e treguesve gjinore, nga të cilët 22 janë tregues të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për të arritur në këtë publikim kaq të plotë të treguesve gjinorë dua të falënderoj të gjithë stafin e INSTAT.

Elsa Dhuli, PhD
Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT

Preface and acknowledgements "Men and Women in Albania, 2021"

"Men and Women in Albania" is an annual publication, which presents data on different areas of life divided by gender, in order to reflect the problems of society in terms of achieving gender equality.

The chapters included in this publication reflect different areas of gender-based data that have been processed and placed in context by INSTAT staff making them easier and more understandable to the general public.

The statistics and indicators presented in this publication will serve policy makers, academia, civil society and various users to analyze in a broader context the gender developments in Albania.

The main purpose of the publication is to present gender data, aiming to not only collect, analyze and present statistics by gender, but also to reflect the society's problems in monitoring cross-sectorial policies on achieving gender equality and achieving sustainable development objectives. New in this year's publication are data from social at conferring including data on registered unemployed persons who receive unemployment benefit, social assistance and social centers for the elderly, as well as some new tables from Survey of Income. The publication also contains the Gender Inequality Index and the Minimal Set of Gender Indicators, which includes 52 indicators by the Statistical Commission in collaboration with UN Women to measure gender indicators, 22 of those indicators are of Sustainable Development Goals.

To achieve this full publication of gender indicators I want to thank all the staff of INSTAT.

Elsa Dhuli, PhD
General Director of INSTAT

Tabela e përmbajtjes

14 **Popullsia**
Population

38 **Shëndeti**
Health

54 **Arsimi**
Education

68 **Tregu i Punës dhe Mbrojtja Sociale**
Labour Market and Social Protection

90 **Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale**
Crime and Criminal Justice Statistics

Statistikat e popullsisë paraqesin situatën, trendet gjinore të popullsisë, si dhe statistika mbi komponentët kryesorë të saj: lindjet, vdekjet dhe martesat.

Statistikat e shëndetit paraqesin të dhëna të detajuara mbi diferencat gjinore në lidhje me shëndetin dhe faktorët që ndikojnë në shëndet, si shkaqet e vdekjeve, sëmundshmërinë nga HIV/AIDS, abortet etj.

Statistikat e arsimit paraqesin të dhëna mbi pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve, duke filluar nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë, të atij publik dhe jo publik, si dhe stafet mësimdhënëse sipas niveleve që parashikohen nga sistemi zyrtar në vend për arsimin.

Statistikat e tregut të punës ofrojnë një pamje të pozicionit që mbajnë burrat dhe gratë në tregun e punës. Ky këndvështrim është shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe produktivitetin ekonomik të një vendi, si dhe për mirëqënien e individëve dhe të familjeve të tyre.

Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale të prezantuara në këtë kapitull pasqyrojnë të dhëna të disagreguara në bazë gjinore duke u fokusuar kryesisht në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë; polici, prokurori, gjykatë, dhe burgje.

Population statistics show the situation of gender trends of the population, and statistics on its main components: births, deaths and marriages.

The health display detailed data on sex differences regarding health, such as: abortions, causes of death, HIV/AIDS morbidity etc.

Education statistics present data on girls and boys, as well as academic staff participation from pre-school education to higher education, in both formal and informal, according to the levels foreseen by the official education system in the country.

Labour market statistics provide an overview of the gender situation in the labour market. This perspective is very important for both a country's economic growth and productivity, as well as for the life of individuals and their families.

Crime and criminal justice statistics presents gender disaggregated data, focusing mainly on each stage of the Justice System, police, prosecution, court and prison.

Table of Contents

104

Gratë në vendimmarrje

Women in Decision-making

Pjesa e parë përmban të dhëna administrative nga Kuvendi i Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Forcat e Armatosura etj. Pjesa e dytë përfshin të dhëna nga Banka e Shqipërisë dhe Regjistri i Biznesit për gratë të cilat janë pronare ose drejtojnë një biznes.

The first part contains administrative data from the Parliament, General Directorate of State Police, Armed Forces, etc. The second part includes data from the Bank of Albania and Business Register for Women who own or manage a business.

126

Tregues social nga Anketat në Familje

Social Indicators from Households Surveys

Ky kapitull paraqet të dhëna të disagreguara sipas gjinisë dhe është konceptuar në disa pjesë bazuar në llojin e anketës nga janë siguruar të dhënat.

This chapter presents disaggregated gender-based data and is conceived in several parts based on the type of survey from which the data were provided.

144

Të Drejtat e Njeriut

Human Rights

Statistikat mbi të drejtat e njeriut pasqyrojnë të dhëna sipas gjinisë mbi ankesat për pretendime shkeljeje të të drejtave, të trajtuar nga Avokati i Popullit, sipas llojit të së drejtës.

Human rights statistics reflect gender-based data on complaints of alleged violations of rights, handled by the People's Advocate, according to the type of right.

152

Indeksi i Pabarazisë Gjinore

Gender Inequality Index

Indeksi i Pabarazisë Gjinore (IPGJ), është një tregues i përbërë, i modeluar në mënyrë të tillë që të paraqesë nga ana sasiore humbjen në zhvillimin njerëzor të mundshëm në një vend, si rezultat i pabarazive gjinore.

The Gender Inequality Index (GII) is an index for measurement of gender disparity in terms of human development of a country, as a result of gender inequalities.

156

Seti minimal i treguesve gjinorë

Minimal Set of Gender Indicators

Publikimi përmban Indeksin e Pabarazisë Gjinore dhe Setin Minimal të Treguesve Gjinorë, i cili përfshin 52 tregues të përcaktuar nga Komisioni Statistikor në bashkëpunim me UN Women për matjen e treguesve gjinorë, nga të cilët 22 janë tregues të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshem.

The publication also contains the Gender Inequality Index and the Minimal Set of Gender Index, which includes 52 indicators by the Statistical Commission in collaboration with UN Women to measure gender indicators, 22 of those indicators are of Sustainable Development Goals.

HYRJE

Publikimi "Burra dhe Gra në Shqipëri 2021" publikohet me periodicitet vjetor nga INSTAT. Qëllimi kryesor i publikimit është të paraqesë të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke synuar që statistikat jo vetëm të mblidhen, analizohen dhe prezantohen sipas gjinisë, por dhe të reflektojnë problematikat e shoqërisë për monitorimin e politikave ndërsektoriale në kuadër të arritjes së barazisë gjinore. Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, i ka përfshirë statistikat gjinore si pjesë të statistikave zyrtare, në mënyrë që, këto statistika të jenë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit. Statistikat dhe treguesit e prezantuar në këtë publikim do t'u shërbejnë politikëbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve të ndryshëm për të analizuar në një kontekst të gjerë arritjet në drejtim të barazisë gjinore.

Publikimi është i konceptuar në kapituj të veçantë, sipas tematikës që mbulohet. Kapitulli i parë trajton statistikat e popullsisë duke paraqitur situatën dhe trendet gjinore të popullsisë. Ky kapitull mbulon statistikat e lindjeve, vdekjeve dhe martesave. Kapitulli i dytë i publikimit "Burra dhe Gra" paraqet në mënyrë të detajuar të dhënat gjinore për shëndetësinë. Ky kapitull përmban të dhëna për abortet, shkaqet e vdekjeve, sëmundshmërinë nga HIV/AIDS si dhe disa të dhëna nga Anketa Demografike e Shëndetit si duhani, alkooli, indeksi i masës trupore, konsumi i zarzavateve dhe frutave etj. Publikimi vijon me statistika gjinore të sistemit arsimor, duke analizuar pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në arsimin zyrtar, si dhe stafet mësimdhënëse sipas niveleve që parashikohen nga sistemi zyrtar në vend, për arsimin.

Kapitulli i katërt përqëndrohet në statistikat e punësimit dhe të mbrojtjes sociale duke evidentuar pjesëmarrjen në tregun e punës, punësimin, papunësinë dhe disa të dhëna administrative për punëkërkuesit e papunë sipas gjinisë. Këtë vit janë përfshirë për herë të parë të dhëna nga mbojtja sociale ku përfshihen të dhëna për punëkërkues të papunë të regjistruar që përfitojnë pagesë papunësie, ndihmë ekonomike si dhe qendrat sociale për të moshuarit.

INTRODUCTION

Publication "Men and Women in Albania 2021" is published yearly by INSTAT. The publication aims mainly at displaying data disaggregated by gender, aiming at the collection, analysis, and presentation of statistics by gender, and mirroring the social issues encountered on the cross-cutting policies monitoring, in the framework of achieving gender equality. The Official Statistics Program 2017-2021 entails gender statistics in the official statistics, so that such statistics is available to all users on an ongoing basis. Statistics and indicators introduced in this publication shall serve to policymakers, academics, civil society and various users to broadly analyze the achievements made towards gender equality.

The publication was designed in separate chapters, depending on the addressed topic. The first chapter addresses population statistics, by depicting the population's situation and gender trends. This chapter covers birth, deaths, and marriage statistics. In the second chapter of the "Men and Women" Publication, gender data on health has been introduced for the first time. This chapter contains data on abortions, death causes, HIV/AIDS, and some data from health demographic survey such tobaccos smokers, alcohol, body mass index, consumption of vegetables and fruits etc. The publication presents further gender statistics on education system, by analyzing girls and boys, as well as academic staff participation in the education system, according to the levels foreseen by the official education system in Albania.

The fourth chapter focuses on employment and social protection statistics, by highlighting labor market participation, employment, unemployment and several administrative data for job seekers by gender. This year, for the first time, data from social protection are included, which include data on registered unemployed jobseekers who receive unemployment benefits, economic assistance and social centers for the elderly.

Kapitulli i pestë trajton statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, i cili analizon autorët, të dëmtuarit dhe statistika të tjera mbi të pandehurit dhe të burgosurit, të ndara sipas gjinisë.

Kapitulli i gjashtë paraqet të dhëna për gratë në vendimmarrje, i cili është konceptuar në dy pjesë. Pjesa e parë përmban të dhëna administrative nga Parlamenti, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të dhëna nga sistemi gjyqësor, diplomatët sipas gradave etj. Pjesa e dytë përfshin të dhëna nga Banka e Shqipërisë dhe Regjistri i Biznesit për gratë të cilat janë pronare ose drejtojnë një biznes.

Kapitulli i shtatë paraqet tregues sipas gjinisë nga anketat sociale në familje si Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave, Anketa e Buxhetit në Familje, Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës dhe nga Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët si dhe disa tabela të reja nga Anketa e të Ardhurave. Kapitulli i tetë përqëndrohet në të drejtat e njeriut dhe analizon ankesat sipas gjinisë për shkelje të së drejtave.

Kapitulli i fundit trajton treguesin e pabarazisë gjinore, i cili përfshin tregues për shëndetin riprodhues, fuqizimin e grave, si dhe pjesëmarrjen në tregun e punës. Publikimi mbyllet me "Bashkësinë Minimale të Treguesve Gjinorë", ku lista e treguesve të përfshirë është përcaktuar nga Komisioni Statistikor në bashkëpunim me UN Women për matjen e treguesve gjinorë. Seti minimal i treguesve gjinorë përfshin 52 tregues nga të cilët 22 janë SDG.

The fifth chapter addresses crime and criminal justice statistics, and provides further analysis on offenders, injured persons, and other statistics on persons involved in criminal justice, disaggregated by gender.

The sixth chapter presents data on women in decision-making and has been designed in two sections. The first section contains administrative data from the Parliament, General Directorate of State Police, data from system of justice, diplomatic body etc. The second section entails data from the Bank of Albania and the Business Register for women owning and running a business.

Chapter seven presents' social indicators disaggregated by sex from social surveys such Violence against Women and Men, Household Budget Survey, Income and Living Conditions Survey and ICT as well as some new table from the income survey. The penultimate chapter focuses on human rights and analyzes gender-based complaints of human rights violations.

The last chapter addresses gender inequality index, which includes reproductive health, women empowerment, and labor market participation indicators. The publication concludes with the "Minimum Set of Gender Indicators", in which the list of included indicators has been determined by Statistics Committee in cooperation with UN Women for measuring gender indicators. This Minimum Set of Gender Indicators" includes 52 indicators, of which 22 are SDG.

LEGJISLACIONI NË FUSHËN E BARAZISË GJINORE NDËR VITE

Që prej vitit 1995, zhvillimet janë të shumta, por më të rëndësishmet në fushën e barazisë gjinore, antidiskriminimit dhe dhunës në familje datojnë nga viti 2006 e në vijim.
Kuadri ligjor për promovimin e barazisë ligjore është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme nga ratifikimi i një sërë dokumentesh të rëndësishëm ndërkombëtar dhe nga amendamente të tjera. Më poshtë paraqiten të renditura ndryshimet më të rëndësishme ndër vite.

LISTA E NDRYSHIMEVE KRYESORE KOMBËTARE NË FUSHËN E BARAZISË GJINORE NDËR VITE (1995 – 2019)

Viti 1995:
1. Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë [ndryshuar]
2. Ligji Nr. 7995, datë 20.09.1995, "Për nxitjen e punësimit"

Viti 1998:
1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Viti 1999:
1. Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" [ndryshuar]

Viti 2002:
1. Ligji Nr. 8876, datë 04.04.2002 "Për shëndetin riprodhues"

Viti 2004:
1. Ligji Nr. 9188, datë 12.02.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal"
2. Ligji Nr. 9198, datë 01.07.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (i shfuqizuar)
3. Strategjia Kombëtare për HIV/AIDS, 2004-2010

Viti 2005:
1. Ligji Nr. 9398, datë 12.05.2005, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për Avokatin e Popullit"

Viti 2006:
1. Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

LEGISLACION IN THE FIELD OF GENDER EQUALITY

From 1995 there have been many developments, but the most important in the area of gender equality, antidiscrimination and domestic violence are dated after 2006.
The legal frame for the promotion of legal equality has been considerably improved by the ratification of a series of important international document and by other ammendations. The most important changes are listed below.

LIST OF THE MAIN NATIONAL CHANGES IN THE FIELD OF GENDER EQUALITY (1995 – 2019)

Year 1995:
1.Law no. 7961, 12.7.1995 "The Code of Labour of the Republic of Albania" [changed]
2.Law no. 7995, 20.09.1995 "For the Promotion of Labour"

Year 1998:
1.The Constitution of the Republic of Albania

Year 1999:
1.Law no. 8454, 04.02.1999 "For the Ombudsman" [changed]

Year 2002:
1. Law no. 8876, 04.04.2002 "For the Reproductive Health"

Year 2004:
1.Law no. 9188, 12.02.2004 "On Some Additions and Changes in the Penal Code"
2.Law no. 9198, 01.07.2004 "On Gender Equality in the Society" (repealed)
3.National Strategy on HIV/AIDS 2004-2010

Year 2005:
1. Law no. 9398, 12.05.2005 "On Some Additions and Changes in the Law for the Ombudsman"

Year 2006:
1.Law no. 9669, 18.12.2006 "On the Measures on Domestic Violence"

Viti 2007:

1. Strategjia e parë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje (SKBGJ-DHF) 2007-2010

Viti 2008:

1. Ligji Nr. 9914, datë 12.05.2008 "Për disa shtesa në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
2. Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
3. Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë
4. Ligji Nr 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike"

Viti 2009:

1. Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë'

Viti 2010:

1. Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
2. Ligji Nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"
3. Ligji Nr. 10295, datë 01.07.2010 "Për faljen"
4. Ligji Nr. 10347, datë 04.11.2010 'Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve"

Viti 2011:

1. Ligji Nr.10.399, datë 17.03.2011,"Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"[ndryshuar]

Viti 2013:

1. Udhëzimi i përbashkët Nr. 21, datë 21.06.2013, midis MPÇSSHB dhe Ministrisë së Financave "Për përcaktimin e procedurave që duhet të ndiqen për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm"

Viti 2014:

1. Plani Kombëtar i Grave Sipërmarrëseve 2014-2020
2. Plani Kombëtar i Burrave dhe Djemve si partner të grave dhe vajzave kundër dhunës në familje
3. Programi i nxitjes së punësimit "Për punëkërkuesit e papunë në vështirësi". VKM nr. 48, datë 11.01.2012, ndryshuar me VKM nr. 192, datë 02.04.2014
4. Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë. VKM nr. 47, datë 16.01.2008, ndryshuar me VKM nr. 193, datë 02.04.2014

Year 2007:

1.First National Strategy for Gender Equality and the Elemination of Domestic Violence (NSGE-DV) 2007-2010

Year 2008:

1.Law nr. 9914, 12.05.2008 "On Some Changes on the Law nr.9669, 18.12.2006 " On the Measures on Domestic Violence"
3.Law no.9970, 24.07.2008 "On Gender Equality in the Society".
4.Law no.10019, 29.12.2008 "Electoral Code of the Republic of Albania"
5.Law no. 10039, 22.12.2008 "For juridical assistance"

Year 2009:

1.Law no.10192, 03.12.2009 "On the Prevention and Elimination of Organized Crime and Trafficking Through Preemptive Measures on Personal Wealth"

Year 2010:

1.Law no. 10221, 04.02.2010 "On the Protection from Discrimination"
2.Law no.10237, 18.02.2010 "On Health Security at Work"
3.Law no. 10295, 01.07.2010 "On Pardoning"
4.Law no. 10347, 04.11.2010 "On the Protection of Children's Rights"

Year 2011:

1.Law no.10399, 17.03.2011 "On assistance and social services" [changed]

Year 2013:

1. Common Instruction No. 21 dated 21.06.2013, between MoLSAO and the Ministry of Finance "on definition of procedures that must be followed for gender integration in medium term budget program"

Year 2014

1. National Action Plan for women entrepreneurship 2014-2020
2. National Action Plan for the involvement of men and boys as partners of women and girls in actions for gender equality and against gender based and domestic violence
3. Employment Promotion Program "For unemployed jobseekers in difficulty" no.48, 11.01.2012, amended with no. 192, 02.04.2014
4. Employment Promotion Program through Job Training. no. 47, 16.01.2008, amended by no.193, 02.04.2014

Viti 2015

1. Ndryshimet në Kodin zgjedhor për vendosjen e kuotës 50 % burra dhe 50 % gra në listat e kandidatëve për këshilltar/ret në zgjedhjet vendore 2015

Viti 2016

1. Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe plani veprimit 2016-2020
2. Ligji Nr.70/2016 "Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë", Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me 30.06.2016
3. Kuadri ligjor (Ligji Nr. 44/2016, datë 21.04.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar)

Viti 2018

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar me ligji Nr. 47/2018 datë 23.07.2018

Viti 2019

1. Ligj nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH"
2. Ligji Nr 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"
3. VKM nr. 380, datë 05.06.2015 "Për miratimin e dokumentit politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij"
4. VKM nr. 866, datë 24.12.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj"
5. Vendim nr. 864, datë 24.12.2019 "Për miratimin e Dokumentit Politik Kombëtar për Moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij"
6. VKM Nr. 659, datë 10.10.2019 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 - 2022

Viti 2020

1. Ligjin Nr.9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdheniet familjare", i ndryshuar.
2. Kodi Penal me Ligjin Nr. 35/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

Year 2015

1. Amendments introduced to the Electoral Code with the Law 74/2012 to ensure 50 % women at local councils at the new LGU

Year 2016

1. National Strategy on Gender Equality and Action Plan 2016-2020
2. Law No.70 / 2016 "On Craftsmanship in the Republic of Albania" - Adopted by the Assembly of Albania on 30.06.2016
3. Legal Framework (Law No. 44/2016, 21.04.2016 "On some Amendments and addenda to Law Nr. 9355, 10.03.2005," On Social Assistance and Services ", as amended)

Year 2018

1. "On some Amendments and addenda to Law Nr. 9669, 18.12.2006, "For Measures against Violence in Family Relations", as amended law no. 47/2018, 23.07.2018

Year 2019

1. Law no. 57/2019 "On social assistance in the Republic of Albania"
2. Law No. 15/2019 "On the promotion of employment"
3. "On the approval of the political document" Reform of the disability assessment in the social protection system and the action plan 2019-2024 for its implementation ", no. 380, dated 05.06.2015
4. "On the approval of the National Strategy for Social Protection 2020-2023 and the action plan in its implementation", no. 866, dated 24.12.2019
5. Decision no. 864, dated 24.12.2019 "On the approval of the National Political Document on aging, 2020-2024, and the action plan for its implementation"
6. On the approval of the National Strategy for Employment and Skills 2019 – 2022, no. 659, dated 10.10.2019

Year 2020

1. Law No. 9666/2006 "On measures against domestic violence", as amended.
2. Criminal Code with Law no. 35/2020 "On some additions and changes to law no. 7895, dated 27.1.1995, "Criminal Code of the Republic of Albania", as amended ".

GRATË DHE BURRAT NË SHQIPËRI

2021

WOMEN AND MEN IN ALBANIA

Populllsia

Population

Statistikat e popullsisë paraqesin situatën, trendet gjinore të popullsisë, si dhe statistika mbi komponentët kryesorë të saj: lindjet, vdekjet dhe martesat.

Population statistics show the situation of gender trends of the population, and statistics on its main components: births, deaths and marriages.

Dinamikat e popullsisë

Popullsia e Shqipërisë në 1 Janar 2021 është 2.829.741 persona, duke pësuar një rënie prej 0,6 % gjatë 2020. Gjatë këtij viti, numri i grave në Shqipëri është ulur me një normë prej 0,4 % ndërsa popullsia e burrave ka rënë me 0,7 %. Në vitin 2020, gratë përbëjnë 50,2 % të popullsisë gjithsej.

Shtesa natyrore, gjatë vitit 2020 është më e ulët për burrat sesa për gratë, përkatësisht -1.018 dhe 1.488.

Migracioni neto i grave shënon vlerën -7.069 gra të emigruara më shumë sesa të kthyera në 2020. Migracioni neto i burrave është gjithashtu negativ, -9.615 burra të emigruar më shumë sesa të kthyer. Migracioni neto negativ i burrave dhe i grave ka ndikuar në rënien e përgjithshme të popullsisë.

Raporti gjinor sipas grupmoshave tregon se ka një mbizotërim të gjinisë mashkullore deri në grupmoshën 35-39 vjeç.

Mosha mediane për burrat, në fund të vitit 2020 është 36,8 vjeç ndërsa për gratë është 38,6 vjeç. Mosha mediane më e lartë tek gratë shpjegohet me jetëgjatësinë më të lartë të tyre. Në vitin 2020, jetëgjatësia në lindje është llogaritur të jetë 75,2 vite për burrat dhe 79,6 vite për gratë. Kjo do të thotë se gratë jetojnë 4,4 vite më shumë se burrat.

Population dynamics

Albania's population on 1 January 2021 is 2,829,741, decreased by 0.6 % during 2020. During this year the number of women in Albania was decreased by 0.4 %, while the population of men was decreased by 0.7 %. The women population accounts for 50.2 %.

Natural increase of population during 2020 has been lower for men than for women, respectively with -1,018 and 1,488 units.

Net women's migration is -7,069 more emigrated women than returned, in 2020. Net migration of men is also negative with -9,615 more emigrated men than returned. The negative net migration of women and men has affected to the total decrease of population.

The sex ratio by age group indicates a prevalence of the men population up to the age group 35-39 years.

The median age for men, in the end of year 2020 is 36.8 while for women is 38.6 years old. The higher median age of women is due to their higher life expectancy. In 2020 life expectancy at birth was estimated at 75.2 years for men and 79.6 for women. This means that women live about 4 years longer than men.

Lindjet

Numri i lindjeve të vitit 2020 është 28.075 lindje. Raporti gjinor në lindje është 107, që tregon se për çdo 100 vajza të lindura, lindin 107 djem. Ky raport është më i lartë se raporti natyral, i cili është 105. Në vlera absolute, rënia e numrit të lindjeve krahasuar me vitin 2020 është 486 lindje. Për lindjet djem kemi një rënie prej 2,7 %, ndërsa për lindjet vajza rënia është 0,6 %. Indeksi sintetik i fekonditetit (ISF), i cili tregon numrin mesatar të fëmijëve që pritet të lindë një grua në moshë

Births

In 2020, the number of births was approximately 28.078 thousand births. The sex ratio at birth is 107, which indicates that for every 100 born girls, 107 boys are born. This ratio is higher than the natural ratio, which is 105. In absolute terms, there is a decline of 486 births compared to 2020. Male births have decreased by 2.7 %, while female births have decreased by 0.6 %. Total Fertility Rate (TFR) a standard indicator showing the average number of children that a woman at

riprodhuese shënon 1,34 fëmijë për vitin 2020. Kjo do të thotë se në 100 gra pritet të lindin 134 fëmijë, nëse normat e lindshmërisë sipas grupmoshave janë ato të vitit referues 2020. Ky indeks është nën normën e zëvendësimit prej 2,1 fëmijë për grua, që do të thotë se një çift nuk arrin të zëvendësojë veten.

Lindshmëria ka rënë për grupmoshat 20-24 dhe 25-29, ndërsa për grupmoshat më të vjetra ka pësuar rritje të lehtë. Në vitin 2020, mosha mesatare në lindje ishte 29,0 vjeç.

Koeficientët specifikë të lindshmërisë sipas gjinisë për 2020, tregojnë dhe mbështesin faktin se burrat e fillojnë aktivitetin e të paturit fëmijë relativisht më vonë se gratë, afërsisht një 5 vjeçar më vonë, ndërkohë që normat e lindshmërisë pas të 30-ave i kanë më të larta se gratë.

Koeficienti bruto i riprodhimit (KBR) është një tregues i mirë për matjen e rritjes së brezave të ardhshëm. Ai mat normën me të cilën gratë zëvendësojnë veten e tyre gjatë viteve të jetës riprodhuese. Mënyra e llogaritjes së KBR-së është e njëjtë me atë të ISF-së, por në këtë rast merren parasysh vetëm lindjet gra. Në vitin 2020, KBR-ja është 0,65 që do të thotë se gratë në Shqipëri janë rreth 35 për qind larg zëvendësimit të vetvetes. Ky tregues ndikohet direkt nga sjellja riprodhuese e grave e shprehur nga ISF-ja dhe nga raporti gjinor në lindje. Duke supozuar një ISF konstante, rënia e raportit gjinor në lindje do të sillte rritjen e KBR-së. Nga ana tjetër rritja e ISF-së presupozon edhe rritjen e KBR-së.

Lindshmëria në adoleshencë është zvogëluar në krahasim me një vit më parë. Në vitin 2020, ka 13,3 lindje për çdo 1.000 vajza të grupmoshës 15-19 vjeç nga 14,2 lindje që ishin në 2019.

Për çdo moshë teke të grupmoshës 15-19 vjeç është llogaritur përqindja e vajzave të cilat kanë patur lindje dhe përqindja e atyre që nuk kanë bërë një lindje.

Vdekjet

Gjatë vitit 2020, numri i vdekjeve të burrave është 15.504 kurse i grave është 12.101 duke shënuar rritje nga viti i kaluar si për burrat dhe gratë. Vdekjet sipas grupmoshave tregojnë se burrat kanë një përqindje

reproductive age is expected to give birth was 1.34 children for the year 2020, which means that out of 100 women, 134 children are expected to be born, according to 2020 fertility rates. This index is below the replacement levelof 2.1 children per woman, which means that a couple is unable to replace itself.

Fertility by age group has decreased significantly for age groups of 20-24 and 25-29, while older age groups have experienced a slight increase. In 2020, the mean age at birth was 29.0 years.

Age group specific fertility rate for 2020 demonstrate and indicate that men become parents approximately five years later than women. Meanwhile, men's post-30 fertility rates are higher than women's.

The gross reproduction rate (GRR) is a useful indicator for measuring the growth of future generations. It measures the rate at which women substitute themselves during the reproductive years of their life. The GRR calculation method is equivalent to that of the ISF, but only female births are taken into account. During 2020 GRR is 0.65, which indicates that women in Albania are about 35 % away from their self-replacement. This indicator is directly influenced by women's reproductive behavior, expressed by TFR and the sex ratio at birth. Assuming TFR stable, the collapse of the sexratio at birth would cause the increase of GRR. On the other hand, the increase of TFR presumes the increase of GRR.

Adolescent birth rate has decreased compared to the previous year. In 2020 there are 13.3 births per 1000 girls of the 15-19 age groups, as compared to 14.2 births per 1000 girls of the same age group in 2019.

For each single age of the 15-19 years old age group the percentage of girls who have and haven't given birth is calculated.

Deaths

number of deaths in 2020 for men is 15,504 while for women it is 12,101 thus indicating an increase compared to the previous year for both sexes. Deaths by age groups indicate that in all age groups, men

më të lartë të vdekjeve, duke përjashtuar grupmoshën e fundit mbi 84 vjeç. Kjo ndodh pasi jetëgjatësia e burrave është më e ulët se ajo e grave.

Vdekshmëria foshnjore është rreth 10,5 vdekje për një mijë lindje për djemtë dhe 9,5 për vajzat. Ky tregues ka pësuar një rënie për djemtë dhe rritje për vajzat, krahasuar me një vit më parë.

Lëvizjet e brendshme

Në vitin 2020, personat që kanë ndryshuar vendbanimin e tyre brenda vendit në total janë 34.009 ku sipas gjinisë 13.353 janë burra dhe 20.656 gra.

Gjatë këtij viti, numri i migrantëve të brendshëm burra ka pësuar një rënie krahasuar me vitin 2019 ndërsa gratë kanë pësuar rritje.

Martesat

Gjatë vitit 2020, në vendin tonë janë regjistruar rreth 17,5 mijë martesa. Tek gratë rreth 50 % e martesave realizohen deri në moshën 24 vjeç, dhe deri në moshën 29 vjeç janë kryer 78 % e tyre. Kjo shpjegon dhe moshën relativisht të re (krahasuar me burrat) në martesë për gratë e cila është 27,7 vjeç. Për burrat 52 % e martesave realizohen deri në moshën 29 vjeç, dhe 81 % e martesave deri në moshën 34 vjeç. Mosha mesatare e martesës për burrat është 31,1 vjeç.

Norma e martesave të grave sipas grupmoshave ndër vite tregon se ka një rënie të normës së martesës deri në moshën 24 vjeç. Kjo shpjegon dhe rritjen e moshës mesatare në martesë të vajzave.

Në këtë publikim janë llogaritur martesat e hershme për vajzat dhe djemtë në mosha teke për grupmoshën 15-19 vjeç. Numri i vajzave të martuara para moshës 18 vjeç gjatë vitit 2020 është 16. Ky numër është ulur në krahasim me një vit më parë, ku u regjistruan 20 martesa të vajzave nën 18 vjeç. Përqindja e vajzave të martuara në moshat 15 deri 17 vjeç është shumë e ulët, ndërsa shënon vlerat më të larta në moshën 18 dhe 19 vjeç, përkatësisht 6,4 % dhe 5,5 %. Ndërsa djemtë nuk kanë martesa para moshës 18 vjeç dhe përqindja e djemve të martuar në moshën 18-19 vjeç është nën 1%.

have a higher death rate, with the exception of the over 84 year's old age group. This is caused by the lower life expectancy of men compared to women's.

Infant mortality is about 10.5 deaths per 1,000 births for boys and 9.5 for girls. This indicator has decreased for boys and increased for girls compared to the previous year.

Internal movements

During 2020 persons who have changed their place of residence within the country in total are 34,009 where 13,353 are men and 20,656 women.

During this year, the number of male internal migrants has decreased compared to 2019 while women have increased.

Marriages

During 2020 in our country were registered 17.5 thousand marriages. About 50 % of women get married up to the age of 24, and up to 78 % of them by the age of 29. This explains the relatively young age (compared to men) for marriage at 27.7 years old for women. 52 % of men get married up to the age of 29 and 81 % of them get married by the age of 34. The average age for marriage is 31.1 years for men.

The change of marriage rate by age groups over years indicates a decline in the marriage rate up to the age of 24 years old, which explains the slight increase of the average age of women when they get married.

In this publication, early marriages for both girls and boys have been calculated for single ages of the 15-19 years old age group. The number of married girls before the age of 18 in 2020 was 16. This number has decreased compared to the previous year when there were 20 marriages. Meanwhile, the ratio of married girls at the age of 18 is 6.6 % and 5.5 % for the age of 19. On the other hand, there are no marriages for boys before the age of 18 and the percentage of married boys of 18-19 years of age is under 1 %.

Ndryshimet në popullsi
Changes in population
Gjendja në fund të vitit - At the end of the year

Vitet Years	Popullsia-Population		Shtesa natyrore Natural increase		Migracioni neto Net migration		Norma e rritjes vjetore Annual growth rate
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
2016	1.453.541	1.423.050	5.118	5.227	-10.060	587	0,0
2017	1.438.609	1.431.715	4.598	4.039	-19.530	4.628	-0,2
2018	1.429.594	1.432.833	3.358	3.772	-12.375	-2.655	-0,3
2019	1.420.613	1.425.342	3.112	3.512	-12.077	-11.005	-0,6
2020	1.409.982	1.419.759	-1.018	1.488	-9.615	-7.069	-0,6

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Director of Civil Office

Dinamikat e popullsisë, burra
Population dynamics, men



Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Dinamikat e popullsisë, gra
Population dynamics, women



Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Piramidat e popullsisë sipas moshës, 1989, 2011, 2020, 2031
Population pyramids, by age 1989, 2011, 2020, 2031



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Census 2001



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Census 2011



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Popullsia 31.12.2020
Population 31.12.2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Popullsia 2031
Population 2031



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Raporti gjinor i popullsisë sipas grupmoshës në fund të vitit 2020
Sex ratio by age group of population at the end of the year 2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Popullsia sipas grupmoshës
Population by age group

Grupmosha	2011	2020	2031	Age group
Burra - Men %				
Gjithsej	100	100	100	Total
0-14	21,5	16,9	16,5	0-14
15-64	67,7	68,4	62,1	15-64
65+	10,8	14,7	21,4	65+
Gra - Women %				
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	Total
0-14	19,8	16,1	15,1	0-14
15-64	68,3	68,1	62,6	15-64
65+	11,9	15,8	22,2	65+

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT
Shënim: Të dhënat për 2011 i referohen popullsisë sipas Censit 2011, për 2020 i referohen popullsisë në fund të vitit 2020, për 2031 i referohen projeksioneve të popullsisë
Note: Data for 2011 refer Census Population 2011, for 2020 refer population at the end of the year, for 2031 refer the projection of population

Koeficienti i varësisë së të rinjve
Youth dependency ratio



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Koeficienti i varësisë së të moshuarve
Old dependency ratio



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Mosha medianë e popullsisë sipas gjinisë në fund të vitit
Median age of the population by sex in the end of year

Vitet- Years	Mosha medianë - Median age		
	Burra- Men	Gra- Women	Gjithsej- Total
2016	34,3	37,0	35,6
2017	35,0	37,2	36,1
2018	35,7	37,7	36,7
2019	36,3	38,2	37,2
2020	36,8	38,6	37,6

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Të lindur gjallë sipas gjinisë
Live births by sex

Vitet Years	Djem- Boys	Vajza- Girls	Raporti gjinor në lindje Sex ratio at birth
2016	16.401	15.332	107
2017	16.208	14.661	111
2018	15.025	13.909	108
2019	14.893	13.668	109
2020	14.486	13.589	107

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Raporti gjinor në lindje
Sex ratio at birth



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Raporti gjinor sipas rradhës së lindjes, 2020
Sex ratio by birthorder, 2020

Rradha e lindjes Birthorder	Djem Boys	Vajza Girls	Raporti gjinor Sex ratio
1	5.719	5.303	108
2	5.241	4.813	109
3	2.143	2.129	101
4+	685	604	113
Mungojnë / Missing	698	740	94

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Koeficientët specifikë të fertilitetit sipas grupmoshës dhe indeksi sintetik i fekonditetit
Age group specific fertility rate and total fertility rate

Vitet Years	Lindje Live births	Lindshmëria sipas grupmoshës për 1.000 gra Age group specific fertility rate per 1,000 women							ISF* TFR*	KBR** GRR**	Mosha mesatare në lindje Mean age at birth
		15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 49			
2016	31.733	17,7	74,2	106,9	74,7	29,3	4,9	0,2	1,54	0,74	28,1
2017	30.869	16,3	67,2	100,1	76,6	30,4	4,9	0,3	1,48	0,70	28,4
2018	28.934	14,5	60,6	90,2	73,9	30,1	5,3	0,4	1,37	0,66	28,6
2019	28.561	14,2	57,7	86,2	74,9	33,0	6,0	0,5	1,36	0,65	28,9
2020	28.075	13,3	55,4	84,6	74,6	34,5	5,8	0,5	1,34	0,65	29,0

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Lindjet në adoleshencë, 2020
Adolescent birth, 2020

Mosha e vajzave Age of women	Numri i lindjeve Number of births
deri 15 / up to 15	44
16	96
17	164
18	309
19	646

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Indeksi sintetik i fekonditetit
Total fertility rate



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Koeficientët specifikë të lindshmërisë sipas gjinisë, 2020
Specific fertility rate by sex, 2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Koeficientët specifikë të fekonditetit sipas grup-moshës
Age group specific fertility rate



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Lindshmëria e femrave në adoleshencë sipas moshave teke, 2020
Adolecent female birth rate by single age, 2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Vdekjet sipas gjinisë
Deaths by sex

Vitet Years	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total
2016	11.283	10.105	21.388
2017	11.610	10.622	22.232
2018	11.667	10.137	21.804
2019	11.781	10.156	21.937
2020	15.504	12.101	27.605

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Vdekjet nën 1 vjeç sipas gjinisë
Infant deaths by sex

Vitet Years	Djem Boys	Vajza Girls	Gjithsej Total
2016	146	131	277
2017	130	118	248
2018	146	111	257
2019	167	126	293
2020	152	129	281

Vdekshmëria foshnjore për 1000 lindje
Infant deaths per 1000 live births



	2016	2017	2018	2019	2020
Djem-Boys	8,9	8,0	9,7	11,2	10,5
Vajza-Girls	8,5	8,0	8,0	9,2	9,5

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Vdekshmëria sipas grupmoshave dhe gjinisë, 2020
Mortality by age group and sex, 2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Jetëgjatësia në lindje
Life expectancy at birth



	2016	2017	2018	2019	2020
Burra/ Men	77,0	77,1	77,4	77,6	75,2
Gra / Women	80,1	80,0	80,5	80,6	79,6

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Lëvizjet e brendshme sipas moshës, burrat
Internal movements by age, men

Grupmoshat Age group	Burra-Men				
	2016	2017	2018	2019	2020
0-4	1.370	1.471	471	758	814
5-9	1.545	1.391	757	889	971
10-14	1.253	1.199	551	743	849
15-19	1.275	1.290	469	711	837
20-24	1.673	2.065	610	1.204	1.097
25-29	2.784	2.887	1.262	1.970	1.699
30-34	2.448	2.451	1.361	2.037	1.745
35-39	1.604	1.693	845	1.331	1.291
40-44	1.194	1.342	576	945	842
45-49	1.015	1.159	420	781	670
50-54	866	952	328	655	611
55-59	866	986	351	591	515
60-64	782	806	311	462	471
65-69	766	805	355	467	456
70-74	374	405	190	274	233
75-79	209	194	110	144	145
80-84	104	93	58	67	76
85+	33	46	34	30	31
Gjithsej - Total	20.161	21.235	9.059	14.059	13.353

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Lëvizjet e brendshme sipas moshës, gratë
Internal movements by age, women

Grupmoshat Age group	Gra-Women				
	2016	2017	2018	2019	2020
0-4	1.207	1.426	428	718	794
5-9	1.372	1.340	716	870	996
10-14	1.253	1.092	536	719	777
15-19	4.453	2.946	860	1.552	1.620
20-24	9.997	6.067	4.223	4.335	4.519
25-29	7.608	5.369	4.341	4.132	4.349
30-34	3.667	2.860	2.291	2.301	2.337
35-39	1.877	1.682	1.135	1.265	1.300
40-44	1.318	1.239	625	850	885
45-49	1.015	1.072	441	613	683
50-54	966	1.001	387	562	572
55-59	967	924	381	498	498
60-64	1.001	1.050	446	578	616
65-69	407	513	242	356	331
70-74	288	248	120	152	158
75-79	166	186	112	107	107
80-84	115	99	43	54	68
85+	79	67	51	59	46
Gjithsej - Total	37.756	29.181	17.378	19.721	20.656

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Lëvizjet e brendshme sipas moshës dhe gjinisë, 2020
Internal movements by age and sex, 2020



Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Lëvizjet e brendshme sipas moshës dhe gjinisë, 2016 vs 2020
Internal movements by age and sex, 2016 vs 2020



Lëvizjet e brendshme 2016
Internal movements 2016

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT



Lëvizjet e brendshme 2020
Internal movements 2020

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Martesat sipas gjinisë dhe grupmoshës
Marriages by sex and age

Grup-mosha	2016	2017	2018	2019	2020	Age group
Dhëndurët - Bridegroom						
Gjithsej	22.562	22.641	23.104	22.415	17.473	Total
Deri 19	88	120	165	153	125	Up to 19
20 - 24	2.787	3.225	3.399	3.390	2.328	20 - 24
25 - 29	9.051	9.188	9.057	8.525	6.567	25 - 29
30 - 34	6.600	6.179	6.422	6.284	5.126	30 - 34
35 - 39	2.256	2.155	2.250	2.173	1.886	35 - 39
40 - 44	915	857	879	896	664	40 - 44
45 - 49	408	432	446	447	350	45 - 49
Mbi 50	457	485	486	547	427	Over 50
Nuset - Bride						
Gjithsej	22.562	22.641	23.104	22.415	17.473	Total
Deri 19	3.339	3.827	3.656	3.382	2.313	Up to 19
20 - 24	9.052	8.836	8.734	7.957	6.179	20 - 24
25 - 29	6.342	6.024	6.219	6.070	5.098	25 - 29
30 - 34	2.210	2.182	2.343	2.457	2.064	30 - 34
35 - 39	819	899	1.029	1.096	833	35 - 39
40 - 44	427	399	530	664	420	40 - 44
45 - 49	194	239	299	362	279	45 - 49
Mbi 50	179	235	294	427	287	Over 50

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Përqindja e martesave sipas grupmoshave dhe gjinisë, 2020
Percentage of marriages by age group and sex, 2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Divorcet me kërkesën e bashkëshortes/bashkëshortit
Divorce at the request of the spouse

Vitet Years	Me kërkesën e bashkëshorit - With request of husband	Me kërkesën e bashkëshortes - With request of wife
2015	2.534	3.000
2016	3.039	3.180
2017	3.042	3.198
2018	3.001	3.578
2019	3.464	4.326

Burimi: Ministria e Drejtësisë
Source: Ministry of Justice
Shënim: Të dhënat e fundit i përkasin vitit 2019.
Note: The latest data refer to year 2019.

Normat e martesave sipas grupmoshës së burrave
Marriage rates by age group of men



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Normat e martesave sipas grupmoshës së grave
Marriage rates by age group of women



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Martesat e hershme tek djemtë, 2020
Early marriages of boys, 2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Martesat e hershme tek vajzat, 2020
Early marriages of girls, 2020



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Mosha mesatare e martesës sipas gjinisë dhe diferenca moshore në martesë
Mean age of marriage by sex and the age diference in marriage

Vitet Years	Burra Men	Gra Women	Diferenca e moshës mesatare në martesë Diference of mean age in marriage
2016	31,3	27,0	4,3
2017	31,0	27,0	3,9
2018	31,0	27,4	3,6
2019	30,9	27,8	3,1
2020	31,1	27,7	3,4

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Mosha mesatare e martesës sipas gjinisë
Mean age of marriage by sex



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Shëndeti

Health

